



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:900392

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05804514

KPPP.nr. 27/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Meditech” Sh.P.K., me nr. të biznesit 70959011 dhe me seli në Prishtinë, me adresë Rruga e Livadhit p.n., që sipas autorizimit përfaqësohet nga shoqëria e avokatëve “Ramaj & Palushi” me seli në Prishtinë, kundër debitorit Ministria e Shëndetësisë – me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 917/18 të datës 09.10.2018, të lëshuar nga Përbaruesi Privat Rezarta Metaj me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 10.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Ministria e Shëndetësisë me seli në Prishtinë ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 917/18 i datës 09.10.2018, i lëshuar nga Përbaruesi Privat Rezarta Metaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Meditech” Sh.P.K., me datë 09.10.2018 ka lëshuar Urdhrin përbarimor P.nr. 917/18 me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit faturë nr. 005505/2018 të datës 23.07.2018, ashtu që është detyruar debitori Ministria e Shëndetësisë, që në emër të borxhit të papaguar nga fatura e lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 36,912.51 EUR (tridhjetë e tremijë e nëntëqind e dymbëdhjetë euro e pesëdhjetë e një euro cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e arritjes për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore për aq sa do të krijohen në këtë procedurë përbarimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin për lejimin e përmbarimit me arsyetimin se palët ndërgjyqëse, kanë pasur të nënshkruar kontratën për “furnizim me insulina analoge për DF-MSh” me nr. të prokurimit 206-17-5049-1-1-4 dhe se bazuar në këtë kontratë, me datë 18.05.2018, debitori ka lëshuar urdhër blerje me nr. 2018-20921 me vlerë totale prej 658,238.88 EUR, ndërsa debitori, lidhur me këtë urdhër blerje ka pranuar faturën nr. 005505/2018 të datës 23.07.2018 nga kreditori. Ka sqaruar se urdhër blerja nuk është realizuar plotësisht pasi që ka pasur vonesa në liferim të mallit nga kreditori andaj si rezultat i këtyre vonesave, debitori, në mbështetje të nenit 14 të kontratës, ka zbritur dëmet e likuiduara nga pagesat në vlerë prej 36,912.51 EUR, e për të cilën zbritje, debitori është informuar me komunikimin elektronik të datës 11.09.2018. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të pranohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbarimit të anulohet.

Kreditori në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit duke shtuar se prapësimi i tillë nuk është i mbështetur me asnjë provë të vetme ashtu siç kërkohet me nenin 69 të LPP-së. Tutje ka sqaruar se në rastin konkret, nuk qëndrojnë pretendimet se kreditori ka shkaktuar vonesa në liferim të mallit pasi që vonesat kanë ardhur si pasojë e përgjegjësisë së vet debitorit në njërën anë dhe si pasojë e veprimeve të forcës madhore, gjegjësisht pamundësisë së prodhimit nga ana e vet prodhuesve të mallrave të tilla. Ka theksuar tutje se nga debitori është urdhëruar që të zbatohet kontrata në vlerën prej 130% të saj në një afat prej më pak se 4 muaj, andaj si pasojë e mungesës së planifikimit të duhur nga ana e vet Ministrisë, janë kërkuar furnizime në sasi tepër të mëdha brenda një afati shumë të shkurtër. Ka theksuar se meqenëse sipas kontratës, afati për zbatimin e saj ka qenë 12 muaj, nënkupton se shpërndarja e mallrave është dashur të bëhet në mënyre lineare, por që përkundër kësaj, debitori ka kërkuar zbatimin e saj brenda katër (4) muajsh dhe se ka qenë obligim i debitorit që të bëjë zgjatjen e periudhës së ekzekutimit dhe dorëzimit të mallit. Gjykatës i ka kërkuar që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbarimit duhet mbetur në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr. 1336/18 të datës 21.08.2020 ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin përmbarimor P.nr. 917/18 i datës 09.10.2018, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj e ka lënë në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr. 1369/22 të datës 18.09.2023 ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit Ministria e Shëndetësisë, ka anuluar aktvendimin PPP.nr. 1336/18 të datës 21.08.2020 të lëshuar

nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj gjykate. Në arsyetimin e saj, gjykata më e lartë ka theksuar se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi, është e bashkangjitur në kopje dhe se në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se fatura është pranuar nga debitori, kjo meqenëse nga flete dërgesat e datës 05.07.2018, 20.07.2018, 23.07.2018 dhe 18.06.2018, në pjesën e poshtme, si pranues i dërgesës janë emrat e dy personave po që nuk dihet saktë vërtetësia dhe legjitimiteti i tyre. Andaj ka sugjeruar shkallën e parë që të eliminohen vërejtjet e tilla dhe të vlerësohen edhe njëherë a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbarimit.

Gjykata, në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*” dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura nr. 005505/2018 e datës 23.07.2018 mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi nuk është e përshtatshme për përmbarim në mungesë të tipareve të përmbarueshmërisë së saj.

Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që nga provat e bashkangjitura nga debitori përmes prapësimit, rezulton se pas pranimit formal të faturës, debitori, në mbështetje të nenit 14 të Kontratës së lidhur mes palëve ndërgjyqëse për “*Furnizim me insulina analoge për DF-MSh*” me nr. të prokurimit 206-17-5049-1-1-4, ka aplikuar penalitete kontraktuese ndaj lartësisë së faturës së lëshuar nga kreditori dhe të pranuar formalisht nga debitori, kjo për shkak të pretendimeve të debitorit për vonesa në liferimin e mallit. Kësisoj, rezulton se palët ndërgjyqëse, me vullnetin e tyre janë pajtuar që debitori të bëjë vlerësimin paraprak të kërkesës për pagesë të

debitorit, dhe ta ekzekutoj në mënyrë të plotë kërkesën për pagesë vetëm atëherë kur konstaton se nuk ekzistojnë vonesa në liferimin e mallit.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se me vet faktin që debitori, pas pranimit të kërkesës së kreditorit për pagesën e faturës nr. 005505/2018 të datës 23.07.2018, kërkesë kjo e dërguar përmes adresës elektronike të datës 10.09.2018, në të njëjtën korrespondencë, me datë 11.09.2018 e ka njoftuar kreditorin lidhur me mos pagesën e vlerës prej 36,912.51 EUR për shkak të aplikimit të penalteteve kontraktuese, rezulton se e ka kundërshtuar faturën në këtë vlerë të borxhit. Rrjedhimisht fatura nr. 005505/2018 të datës 23.07.2018, për pjesën e papaguar të saj, nuk është e përshtatshme për përbarim në mungesë të konfirmimit të debitorit edhe për këtë pjesë të borxhit. Nga të lartcekurat, Gjykata gjen se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, par.1, nën-par.1.1 të LPP-së me të cilin parashihet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse *“dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmerisë”*.

Gjykata rikujton se në procedurë përmbarimore e cila i nënshtrohet formalitetit rigoroz, vlerësohen vetëm elementet formale të faturës dhe të vërtetuarit se a është pranuar fatura nga ana e debitorit në tërësinë e saj, si në aspekt formal ashtu edhe në aspekt të detyrimit që rrjedh nga jo, ndërsa në rastin konkret, debitori ka kundërshtuar faturat e pranuar formalisht, dhe atë në përputhje me autorizimet të cilat i ka pasur nga kontrata e lidhur mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se në këtë procedurë përmbarimore, gjykata nuk shqyrton themelësinë e penalteteve kontraktuese të aplikuara nga debitori për kreditorin, por vetëm aspektin procedural të këtij kundërshtimi dhe efektin e tij në përshtatshmërinë e një dokumenti të besueshëm. Andaj nëse kreditori pretendon se debitori pa të drejtë ka bërë ndalesa në faturat objekt i këtij përbarimi, i njëjti nuk ka asnjë pengesë që këto pretendime t'i paraqes në kontest të rregullt juridik civil.

Gjykata pati parasysh vërejtjet e dhëna nga Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate se fatura mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi është bashkangjitur në kopje, por që në shkresat e lëndës rezulton se të njëjtës faturë, i është bashkangjitur dokumenti vërtetimi i dokumentit nga origjinali me LRP.nr. 2257/2018 i datës 05.10.2018 i lëshuar nga zyra e noterit Kolë T. Ramaj dhe i cili dokument, përkundër që është bashkangjitur po ashtu në kopje, konfirmon faktin se

fatura e bashkangjitur në propozimin për përmbarim, paraqet faturë e cila është vërtetuar në mënyrë identike me origjinalin e saj.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 64 par.4, nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 27/24, datë 10.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.